

VENDIM
Nr.662, datë 18.12.2007

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT
“TV PËRSËRITËS RAI”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 33, pika 1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.576, datë 27.4.2007 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv privat me përsëritës “TV RAI”, pasi nuk ka shfaqur interes për rinovimin e licencës.
2. Subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)